

## *Mbi sfondin dhe ndikimin e mundshëm të epistemologjisë në shfaqjen e post të vërtetës*

*Hajdin Abazi \**

### **Abstrakt**

Qëllimi i kësaj trajtese është të nxjerrë në pah sfondin e post-të vërtetës si një pikëpamje, domethënë disa nga burimet dhe kushtet prej të cilave ka buruar ajo. Duke u bazuar në zhvillimet kundërthënëse filozofike përgjithësisht dhe sidomos të atyre epistemologjike të shekullit XX e që po vazhdojnë edhe sot e kësaj dite, argumentimi do të mbështetet, në njërin anë, në pikëpamjen e verifikacionizmit, sipas së cilës teoritë shkencore konfirmohen po qe se referenca e predikimeve të tyre konstatohet dhe shkencëtarët duhet t'i verifikojnë ato; si dhe, në anën tjetër, në pikëpamjen e falsifikacionizmit, sipas të cilës të gjitha teoritë shkencore janë të rreme dhe shkencëtarët duhet t'i falsifikojnë ato. Shtjellimi do të zgjerohet duke përfshirë kontributet e Thomas Kuhn, Imre Lakatos dhe Paul Feyerabend, si dhe të tjerëve. Gjetjet e epistemologjisë se teoritë shkencore janë të rreme, se teoritë kanë ndikim në formimin e fakteve dhe perceptimeve, se dikotomia fakte /vlerat është shembur etj., nxjerrin në pah se si ndoshta qe shtruar rruga për post-të vërtetën. Trajtesa do të realizohet përmes qasjes së parashtrimit teorik, të shqyrtimit të argumenteve për dhe kundër dhe të analizës, për të përfunduar se post-e-vërteta si pikëpamje mund të jetë në mënyrë të tërthortë rrjedhojë e zhvillimeve të përgjithshme në filozofi dhe sidomos në epistemologji.

**Fjalë kyç:** *filozofi, epistemologji, verifikacionizëm, falsifikacionizëm, post-e-vërteta*

---

\* Prof. Ass. Dr. Hajdin Abazi, Kolegji AAB. [hajdin.abazi@aab-edu.net](mailto:hajdin.abazi@aab-edu.net)

## Hyrje

Në këtë shkrim *post-e-vërteta*<sup>1</sup>, ndonëse ende nuk ka ndonjë autor që e ka shtjelluar teorikisht për ta konstituuar atë, konsiderohet si pikëpamje, si një qasje dhe si një mënyrë ndryshe e të menduarit, si një linjë gjykimi dhe vlerësimi, si një stil komunikimi dhe shprehjeje, e cila tashmë ka marrë disa konturime, por që do të shkojë sigurisht duke u profilizuar dhe qartësuar edhe më shumë në sfera të ndryshme. Objektivi është të shqyrtohen burimet dhe kushtet të cilat, pa ndonjë qëllim, shtruan rrugën për perceptimin e post-së-vërtetës si koncept dhe si pikëpamje. Qasja këtu do të jetë e vatëruar te disa zhvillime në epistemologji, zhvillime këto që kanë krijuar, natyrisht pa ndonjë qëllim të paravënë, konditat të cilat kanë bërë të mundur pikëpamjen e post-të-vërtetës. Sigurisht se nuk mundet që ky produkt intelektual t'i atribuohet ekskluzivisht epistemologjisë, pasi që meritat edhe më të mëdha i ka mamaja e saj – filozofia<sup>2</sup>.

Struktura e kësaj trajtëse do të nisë me përshkrimin e disa aspekteve përmbajtësore që e karakterizojnë disi post-të-vërtetën si pikëpamje e që tregojnë kuptimin e saj. Do të vazhdohet me filozofinë, ku do të paraqiten përmbledhurazi tensionet dhe minimet e ndërsjella të pikëpamjeve të konsideruara si të vërteta. Më shumë vëmendje, në vazhdim, do t'i kushtohet asaj që mbase ka ndikuar që të trandet përfundimisht koncepti i së vërtetës:

---

<sup>1</sup> Më 16 nëntor 2016, oxford dictionaries, e shpalli post-të-vërtetën fjalë të vitit 2016. Kjo, sigurisht, tregon vetëm një gjë: se ky koncept ka tërhequr vëmendjen dhe është bërë aq i përhapur sa paraqet një qasje tashmë të mainfestuar. Shih <https://en.oxforddictionaries.com/word-of-the-year/word-of-the-year-2016>, parë më 20 nëntor 2017, ora 18:10.

<sup>2</sup> Mbi ndikimin e politikës dhe të zhvillimit teknologjik në shfaqjen dhe përhapjen e post-së-vërtetës, shih Hajdin Abazi "Transformimi përmbajtësor: *post-e vërteta* në mediat e sotme", përfshirë në përmbledhjen e kumtesave të Konferencës së Dytë Ndërkombëtare për komunikimin dhe studimin e medieve, titulluar "Historia e medieve dhe transformimi i medieve", mbajtur më 23 shtator, Kolegji AAB, 2017.

epistemologjia, ku do të paraqitet pikëpamja e verifikacionizmit që e vunë në epiqendër të zhvillimit gjetjen e së vërtetës si masë të përparimit të shkencës dhe pikëpamja e falsifikacionizmit, që tregon pamundësinë e arritjes së vërtetës dhe si alternativë e sjell përgënjeshttrimin si epiqendër të përparimit të shkencës. Pastaj do të parashtrihen disa aspekte konceptuale që treguan se nuk është e vërteta aq immune dhe e mëvetësishme sikurse është pretenduar, se ajo është e ndikuar dhe, mbase, edhe e prodhuar nga teoritë. Kështu do të tregohet, në vazhdim, se si epistemologjia, si disiplinë filozofike, e cila merret drejtpërdrejt me shkencën, zbuloi se shkenca mund të funksionojë fare mire edhe pa e pasur si objektiv, ose si parim rregullues të vërtetën. Dhe pikërisht kështu, epistemologjia duke hequr pengesat konceptuale (se fakti nuk është i kulluar por, se nuk ekziston ndarja fakt-vlerë etj.), shtroi rrugën e lindjes së *pikëpamjes pot-e-vërtetë*. Në përfundim, do të shprehet ideja, bazuar në perspektivën e përshkruar këtu, se filozofia dhe veçanërisht filozofia e shkencës, të dyja, por sidomos kjo e fundit, pa ndonjë qëllim të paracaktuar, është një kontribues i natyrshëm për krijimin e kushteve për lindjen e post- të vërtetës.

### *Post-e-vërteta dhe kuptimi i saj*

Deri më sot nuk ka ndonjë teoricien, i cili e ka përqaftuar pikëpamjen post-e-vërteta dhe ka dalë me ndonjë shtjellim, ndaj, për ta konturuar disi atë, duhet mbështetur nga burime të ndryshme dhe mendime të shpërndara. Tashmë gjenealogjia e konceptit post-e-vërteta është vetëm një aspekt historik<sup>3</sup>, por ajo

---

<sup>3</sup> "Post-vërteta duket se është përdorur për herë të parë në këtë kuptim në një ese të vitit 1992 nga dramaturgu Steve Tesich në revistën 'The Nation'. Duke reflektuar mbi Kundër-skandalin lidhur me Iranin dhe Luftën e Gjirit Persik, Tesiku shpreh keqardhje se 'ne, si një popull i lirë, kemi vendosur lirisht që ne duam të jetojmë në një botë të post-të vërtetës'. Ekzistojnë prova të përdorimit të frazës "post-vërteta" para artikullit të Tesich, por me sa duket

që është me rëndësi, është fakti se ajo është manifestuar si pikëpamje dhe si qasje.<sup>4</sup>

Duket se do të ketë të drejtë Matthew Norman, një kolumnist në "The Independent" londineze, në pohimin se "...ne kemi hyrë në botën e post-të-vërtetës - nuk ka tashmë kthim pas".<sup>5</sup> Duhet pranuar, Norman e kishte goditur saktë, bota ka hyrë në kohën e post-të-vërtetës prej nga nuk mund të ketë më kthim pas. Ne jetojmë tashmë, që nga viti 2016, në një botë ku gjithnjë e më shumë po përhapet post-e-vërteta si pikëpamje dhe si qasje. Ky është një zhvillim, i cili po ndodh dhe do të vazhdojë trajektoren e vet, duke gjeneruar reagime diverse, por edhe duke ushtruar ndikimin e vet.

Për të pasqyruar natyrën e vërtetë të post-të-vërtetës si pikëpamje dhe si qasje, Norman sjell inserte nga një satirë e Baldwin<sup>6</sup>. Meqë Trump e përjeton sikur gjoja Erin po i dilte në

---

me kuptimin transparent "pasi të ishte e njohur e vërteta" dhe jo me implikimin e ri që vetë e vërteta është bërë e parëndësishme. Një libër, Era e Post-të-vërtetës, nga Ralph Keyes doli në drite në vitin 2004 ... " në <https://en.oxforddictionaries.com/word-of-the-year/word-of-the-year-2016>, parë më 20 nëntor 2017.

<sup>4</sup> Oxford Dictionaries e shpalli post-të-vërtetën si fjalë të vitit 2016, nga që përdorimi i saj me një vit më parë ishte rritur për 2000%. Burimi kryesor i përhapjes së saj ishte politika, post-e-vërteta në politikë dhe kjo ishte e lidhur me "referendumin për BE në Britaninë e Madhe dhe zgjedhjet presidenciale në SHBA" gjatë vitit 2016, shih <https://en.oxforddictionaries.com/word-of-the-year/word-of-the-year-2016>, parë më 20 nëntor 2017.

<sup>5</sup> Matthew Norman, "Whoever wins the US presidential election, we've entered a post-truth world - there's no going back now", "Independent", 8 november 2016, në <http://www.independent.co.uk/voices/us-election-2016-donald-trump-hillary-clinton-who-wins-post-truth-world-no-going-back-a7404826.html>, parë më 20 nëntor 2017.

<sup>6</sup> Alexander Rae Bolwind në rolin e Donald Trump, Kate McKinnon në rolin e Hillary Clinton dhe Cecily Strong në rolin e Erin Burnett, në show-lajmet e saj në OutFront, CNN. Për më shumë shih Dennis Perkins, "At the end of an ugly campaign, SNL's Trump and Clinton go on a feel-good rampage", 6

mbrojtje Hilary Clinton, ai thotë: "Pse po e mbron, Erin?... kam dëgjuar nga shumë njerëz ti je në relacion lezbik me të". Erin i thotë "Kjo as që ka kuptim fare.", e Trump shton: "Por s'ka lidhje hiq, Erin, mjafton që unë e thashë. E tash gjysma e vendit e beson atë.". Këtë rrjedh konstatimi i Norman se "E vërteta është bërë kaq e zhvlerësuar sa që ajo që dikur ishte një standard i artë i debatit politik është një monedhë e pavlerë.<sup>7</sup>

Komediani amerikan Stephen Colbert, në vitin 2005, e popullarizoi një fjalë joformale në lidhje me të njëjtin koncept: si e vërtetë (truthiness). Kjo fjalë u përkufizua nga Oxford Dictionaries si 'cilësia e dukjes ose ndjenja e të qenit e vërtetë, edhe pse jo domosdoshmërisht e vërtetë'. Post- e vërteta e shtrin këtë nocion nga një cilësi e izoluar e pohimeve të veçanta, në një karakteristikë të përgjithshme të epokës sonë."<sup>8</sup> Matthew Norman shkruan: "Pak javë më parë, kur një mik përsëriti lajmin e vjetër të rremë rreth asaj se Hillary ishte e sëmurë kronike, unë vura në dukje se kjo thjesht nuk ishte objektivisht e vërtetë. "Unë nuk jap hedhje për të vërtetën objektive," tha ai me atë që mund të shërbejë si motoja heraldike për epokën, "Secili është i lirë të zgjedhë të vërtetën e vet".<sup>9</sup>

Si pikëpamje post-e-vërteta shpreh një gjendje, e cila nuk karakterizohet më nga fjala bazë (e vërteta). Fjala bazë nuk është më karakteristike dhe nuk e ka peshën që e kishte dikur si pikësynim për të gjetur atë që përputhet me realitetin. Qasja që përqendrohet ekskluzivisht nga pikëpamja që shprehte fjala bazë, koncepti i saj themelor, duket se është bërë i pamjaftueshëm për të shprehur tërësinë e asaj që pretendohet. Perceptimi nuk shfaqet më ekskluzivisht nga fjala bazë, por edhe

---

nëntor 2016, gjendet në <https://news.avclub.com/at-the-end-of-an-ugly-campaign-snl-s-trump-and-clinton-1798253954>, parë më 20 nëntor 2017.

<sup>7</sup> Norman, artikull i cituar.

<sup>8</sup> <https://en.oxforddictionaries.com/word-of-the-year/word-of-the-year-2016>, shikuar më 20 nëntor 2017.

<sup>9</sup> Norman, artikull i cituar.

nga shumë elemente të tjera, faktorë, rrethana, motive, ndjenja, përjetime e të ngjashme. Megjithëse prirje të tilla janë shprehur përgjatë tërë historisë së njerëzimit, porse duke u bërë mënyrë publike e komunikimit në vendet (si SHBA dhe Britania e Madhe) ku liria e shprehjes besohej të ishte e bazuar tek e vërteta si strumbullar dhe si referencë gjykimi e vlerësimi, qasja post-e-vërteta është një dukuri, që tregon se opinioni publik, qytetari, është zvetënuar në interesimin e tij për të vërtetën dhe se krahas saj janë vënë edhe aspekte të tjera, që duken të kenë peshë, si fjala vjen ndjenja, përjetimi, interesimi, besimi individual, perceptimi personal etj. Shekulli XXI duket se ia behu me këtë kurs të ri qasjeje dhe reflektimi.

Një kuptim mjaft të qartë e jepte Oxford Dictionaries: " Fjala e kompozuar *post-e-vërteta* tregon zgjerimin e kuptimit të parashtesës *post-e-vërteta*, cila është rritur në mënyrë të dukshme viteve të fundit. Më shumë se sa referimi të një kohë pas një gjendje specifike ose ngjarjeje – si në *post-luftë* apo *post-ndeshje* - parashtesa në *post-e-vërteta* ka një kuptim më tepër të asaj si 'përkitja e një kohe në të cilën koncepti specifik është bërë i parëndësishëm ose i papeshë'. Nuanca të një kuptimi të tillë duket se janë shfaqur në mes të shekullit XX, në formacione të tilla si *post-nacional* (1945) dhe *post-racial* (1971)"<sup>10</sup>

Por parashtesa *post* nuk është ndonjë përcaktues, por e tregon një gjendje. Ajo nuk e përcakton atë gjendje; ajo tregon se nuk është më gjendja e dikurshme, se është një gjendje e re, por ende e pa përkufizuar më saktësisht, ndaj dhe ajo ruan gjurmët e gjendjes së tejkaluar, ngjyrimin e pikëpamjes që tashmë është spostuar, duke treguar se ajo tashmë nuk është në trend, nuk është më valide, të paktën jo si dikur, por që ende nuk është arritur në një gjendje tjetër, të re, ndryshe.

---

<sup>10</sup> <https://en.oxforddictionaries.com/word-of-the-year/word-of-the-year-2016>, seen November 20, 2017.

Mattew Norman shpalos një realitet të mundshëm që duhet të mbahet parasysh: "Banorët e flluskave të krijuara nga interneti, ku algoritmet i ushqejnë paragjykimet dhe idetë e tyre të gabuara duke konfirmuar çfarëdo bredhi që ata kanë zgjedhur si pohim i tyre i vërtetë, janë qartësisht përtej mundësisë për të arritur te fakti." Po aty: "Kushtet ... për të kapitalizuar dëbimin e së vërtetës objektive në një artefakt elektoral të çuditshëm por irrelevant do t'i mbijetojë atij", sepse "Trumpi nuk është origjinatori i dëshirës frenetike për të ikur nga realiteti. Ai është manifestim i saj"<sup>11</sup>

Kështu, thelbi i pikëpamjes post-e-vërteta mund të shprehet me faktin se ajo është "e drejtuar ose që tregon rrethanat në të cilat faktet objektive janë më me pak ndikim në opinionin publik se sa thirrja në ndjenja dhe besime personale".<sup>12</sup> Ky konceptim mund të jetë prirje e kohës sonë, porse nuk është një frymë krejt e panjohur nga më parë, pasi që në historinë e mendimit trendë të ngjashëm janë manifestuar herë pas here ndër shekuj jo vetëm në politikë, por edhe në filozofi, e sidomos gjatë shekullit XX në epistemologji, që do të kenë pasur ndikim, qoftë edhe tërthorazi, në shfaqjen e post-të-vërtetës, gjë që edhe mund të jetë një burim i saj interesant për t'u shqyrtuar.

### *Prirja kontestuese e filozofisë*

Kuptimi leksikografik i termit filozofi është 'dashuri ndaj dijes', e dije konsiderohet ajo që është e vërtetë, rrjedhimisht filozofia ishte konceptuar si dashuri ndaj së vërtetë, dijes së vërtetë dhe jo çfarëdolloj dije të mundshme. Dija e vërtetë, të cilën donte ta arrinte filozofia, mbështetej në gjendje të qëndrueshme, në

---

<sup>11</sup> Norman, artikull i cituar.

<sup>12</sup> <https://en.oxforddictionaries.com/word-of-the-year/word-of-the-year-2016>, seen November 20, 2017.

fenomene ekzistuese, në marrëdhënie që ishin konsistente dhe në ngjarje që ndodhin, ashtu sikurse ndodhnin. Ajo që e karakterizonte filozofinë, për dallim nga disiplinat e tjera të dijes (si matematika, gjeometria, astronomia, fizika, biologjia, sociologjia, psikologjia etj.), ishte se ajo nuk kërkonte dije specifike, por kurora të dijes, të cilat shkonin përtej dijeve konkrete, duke kërkuar dhe duke gjetur (gjasme) parime të përgjithshme, që vlenin universalisht dhe pa ndonjë përjashtim, e që teoritë e ndryshme filozofike të ishin “të vetë-qëndrueshme”<sup>13</sup> në kuptimin që nuk mbështeteshin te ndonjë autoritet, por te konsistenca e argumenteve dhe e pikëpamjeve të parashtruara.

Përkundër kësaj, pra se filozofia ishte dashuri ndaj dijes, ajo kishte edhe anën tjetër të medaljes. Që nga zanafilla e deri në ditët e sotme, filozofia ka manifestuar prirjen e kontestimit, si prirje të mospajtimit me teoritë ekzistuese, sado të jenë dukur të vërteta ato dhe pavarësisht autoritetit të autorit, dhe gjithnjë është shquar nga kërkimi i vazhdueshëm, nisur nga arritjet e shënuara për të shkuar më tej, për të gërmuar aty-këtu, duke kritikuar, atakuar me argumente e kundërgargumente pikëpamjet që kanë pretenduar të vërtetën, derisa janë hedhur poshtë për shkak të paqëndrueshmërisë dhe defekteve serioze të tyre kundrejt asaj që e pretendonin. Dhe këta kritikues vetë ose të tjerë kanë shtruar pikëpamjet alternative, të cilat, pasi kanë dominuar për një kohë, kanë pësuar fatin e paraardhësve<sup>14</sup>. Kjo është rruga e zhvillimit të filozofisë ndër shekuj, duke i kontestuar, kritikuar dhe duke shkuar më tej, kështu, fjala vjen, ka bërë Platoni (427-347 para Krishtit (p. Kr.)) kundrejt Sokratit

---

<sup>13</sup> Hajdin Abazi, *Shembja e Olimp. Rënia e zotave – ngrija e njerëzimit. Ese filozofike mbi clirimin botëkuptimor*. Shtëpia botuese Olymp, Prishtinë, 2016, f. 356. Do të citohet shkurtimisht: Hajdin Abazi, *Shembja e Olimp*.

<sup>14</sup> Për një shqyrtim të zhvillimit të këtyre shih Hajdin Abazi, *Shqyrtime të racionalizmit në epistemologji*, Zef Serembe, Prishtinë, 2014, f. 279-309, 339-382, 413-422.



(470-399 p. Kr.); Aristoteli (384-322 p. Kr.) kundrejt Platonit; Immanuel Kant (1724-1804) kundrejt René Descartes (1596-1650); August Comte (1798-1857) kundrejt Thomas Hobbes (1588-1679), John Locke (1632-1704) , David Hume (1711-1776), Immanuel Kant, George Wilhem Friedrich Hegel (1770-1831) etj.

E tërë kjo rrugë zhvillimi në filozofi, shikuar nga këndvështrimi i shqyrtimit këtu, ka domethënie se vetë filozofët do të rrekeshin me tërë fuqinë që të shembnin ato të vërtetat që i kishin postuluar të tjerë kolegë të tyre, duke treguar paqëndrueshmërinë e tyre dhe duke formuluar teoritë e tyre me pretendimin e njëjtë për të vërtetën objektive apo të sigurt. Këtë prirje e ka manifestuar filozofia qysh në zanafillën e vet në antikitetin grek. Fjala vjen, Thalesi (rreth 620-546 p. Kr.) e kishte formuluar një pikëpamje mbi botën, duke marrë ujin si substancën primordiale (arché), përmes të cilës jepte një shpjegim në dukje të qëndrueshëm e të argumentuar mirë, për çka edhe e përqaftuan dishepujt e tij si pikëpamje që shprehte të vërtetën mbi botën, ndër të cilët sidomos Anaximandri (rreth 610-546 p. Kr.) e Anaximeni (rreth 585-528 p. Kr.). Mirëpo, po këta, duke reflektuar në mënyrë kritike më vonë, do të shquajnë mangësi të shpjegimit të Thalesit, dhe do ta hedhin atë poshtë, duke dhënë teoritë e tyre alternative të shpjegimit të botës: Anaximandri me doktrinën e apeironit e Anaximeni me doktrinën e ajrit<sup>15</sup>.

Si Thalesi, edhe Anaximandri e Anaximeni edhe filozofë të tjerë si Pitagora (rreth 570-495 p.Kr.) , Parmenidi (fundit i shek. VI – mesit i shek. V p. Kr.) etj., besonin se ekzistonte një e vërtetë objektive, e sigurt dhe e cila mund të njihet, ndaj dhe e kërkonin atë me besimin se do ta gjenin e mandej t'ua tregonin dhe të tjerëve përmes artikulimit teorik. Besimi se ekziston një e vërtetë e sigurt, e gjithëvlefshme dhe e përhershme mbase ishte e

---

<sup>15</sup> Për jehonën e rëndësinë e pikëpamjes së Thalesit dhe tejkalimin e saj nga dishepujt e shkollës së tij, shih Hajdin Abazi, *Shembja e Olimp* f. 2007-359.

trashëguar, e ngulitur nga bindjet fetare, vetëm se për dallim nga hyjnitë, kërkohej një marrëdhënie, gjendje apo lloj ekzistence objektive respektivisht e përhershme. Këtë ngulitje botëkuptimore, aq sa dihet, krahas Homerit dhe Hesiodit dy poetët më të lashtë grekë, i pari ishte filozofi i antikitetit grek, Xenophanes (rreth 570-478 p.Kr.), kur ai shkroi: “Të vërtetën e sigurt, askush nuk e ka njohur,/As do ta njohë...”.<sup>16</sup> Ky postulat, pa fije dyshimi, lëkundit themelet e filozofisë së asaj kohe, pasi që minonte bazat mbi të cilat besimi i saj në të vërtetën ishte ngritur dhe gëzonte një autoritet suprem, të sigurt, objektiv.

Edhe një filozof tjetër me nam i antikitetit, Heraclitus (535-475 p.Kr.), në këtë frymë, kishte pohuar se nuk është në natyrën ose karakterin e njeriut që të zotërojë dijen e vërtetë.<sup>17</sup> “Herakliti thotë se gjithçka lëviz, pohon Sokrati në dialogun *Kratili* dhe asgjë nuk qëndron dhe ai e ngjason ekzistencën me një lum që rrjedh dhe thotë se “dy herë nuk mund të futesh në të njëjtin lum”<sup>18</sup>. Sipas kësaj doktrine të ndryshimit permanent, ndryshim i cili gjithçka e bënte fluid, duket e natyrshme që njeriu të mos pretendojë ndonjë dije që të quhet e vërtetë. Platoni, do të përpiqet të formulojë një ekzistencë tjetër objektive – idetë si realitete të vërteta, kurse realitetin perceptual si reflektim i saj (p.sh. alegoria e shpellës<sup>19</sup>), por që më pas do të hetojë mangësi, të cilat do t’i pasqyrojë si vetëreflektim te dialogu *Parmenidi*<sup>20</sup>, ku shpalosen vështirësitë për të lidhur njëjësën e idesë objektive me shumësin e referencës së saj në botën perceptuese.

Kështu, si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve intelektuale në të cilat pa dashje, por për nga natyra e saj zhbiruese, çoi filozofia në shfaqjen edhe të pikëpamjeve ekstreme si teza e jo-ekzistencës e

---

<sup>16</sup> Hajdin Abazi, *Shembja e Olimpiti*, f. 361-481; citati po aty. f. 382.

<sup>17</sup> Cituar sipas Popper - *Vepra të zgjedhura*, (ed.) David Miller, f. 29.

<sup>18</sup> Platoni, *Kratylos*, Skrifter, Bok 2, f. 406.

<sup>19</sup> Platoni, *Staten*. Skrifter. Bok 3, Atlantis, Stockholm, 2013, f. 293-302.

<sup>20</sup> Platoni, *Parmenides*. Skrifter, Bok 4, Atlantis, Stockholm, 2006, especially pp. 54-67.

Gorgiasit (rreth 483- rreth 375 p. Kr.) i cili shkoi aq larg sa të pohonte se asgjë nuk ekziston dhe nëse ekziston nuk mund të njihet dhe nëse kjo ndodh, ajo nuk mund të komunikohet<sup>21</sup>. Mandej Protagora (490-420 p. Kr.), i cili masën e të gjitha gjërave, në të cilat sigurisht që përfshihet edhe njohja e së vërtetës, e gjeti te njeriu, si individ: “Njeriu është masa e të gjitha gjërave: për ato që janë se janë, për ato që nuk janë se nuk janë”<sup>22</sup>. Platoni, përmes Sokratit, i ka dhënë të drejtë Protagoras se mbështetur në perceptime, e vërteta është ashtu sikurse secili e përjeton atë<sup>23</sup>.

Ndër shekuj njëra prej pikëpamjeve më të përhapura ndër filozofët kishte qenë bindja se e vërteta ishte një ekzistencë e pavarur, objektive. Grekët e lashtë besonin se kjo e vërtetë mund të kapej vetëm me anë të mendjes, arsyes. Porse George Berkeley (1685-1753), në *Three Dialogues*, në dialogun e parë midis Philonous dhe Hylas, shqyrton raportin midis ekzistencës dhe perceptimit, me pak nuanca të Protagoras, duke arritur në atë që është shumë thënie e mirënjohur: *esse est percipi* (të jesh domethënë të jesh i perceptuar), që domethënë se ekzistenca është vetëm kur perceptohet<sup>24</sup>. Me fjalë të tjera, kjo donte të thoshte se nëse nuk perceptohet nga sekush, atëherë asgjë nuk ekzistonte, e pra as edhe e vërteta (zoti këtu shfaqet si perceptues e rrjedhimisht edhe që e bën të mundur ekzistencën). Këtë trend e shpuri më tutje Devid Hume, i cili do të vinte në radhë të parë pasionin krahasuar me arsyen, duke treguar epërsinë e së parës: “Arsyeja është, dhe duhet të jetë vetëm skllav i pasioneve dhe nuk mund të pretendojë asnjë

---

<sup>21</sup> Pohimi i mirënjohur i Gorgias është: i) Asgjë nuk ekziston; ii) Edhe nëse ekzistenca ekziston, ajo nuk mund te njihet; iii) Edhe nëse ajo mund të njihet, ajo nuk mund të komunikohet. Për më tepër, shih Colin Francis Higgins “Gorgias (483 – 375 B.C.E.)” në

<http://www.iep.utm.edu/gorgias/>, parë më 2 dhjetor 2017.

<sup>22</sup> Platoni, *Thaetetos*, Skrifter, Bok 2, Atlantis, Stockholm, 2001, f. 150, 164, 173.

<sup>23</sup> Për më tepër shih Hajdin Abazi, *Shembja e Olimp*, f. 508-509, 510-527.

<sup>24</sup> George Berkeley, *Principle of Human Knowledge, Three Dialogues*, Oxford University Press, Oxford, 1999, f. 107-147.

detyrë tjetër përveç t'u shërbejë dhe t'u bindet atyre”<sup>25</sup>. Pohime të tilla, pa fije dyshimi, do të kenë sjellë tronditje të mëdha për konceptet ekzistuese filozofike, një lloj shembjeje të asaj që ishte konsideruar e kundërt, pra se perceptimet dhe pasionet ishin dytësore kundrejt arsyes që ishte parësore. Këto pikëpamje, pak a shumë, kishin sjellë një përmbysje të përafërt me atë që duket se ka në objektiv të arrijë pikëpamja e post-të-vërtetës. Vënia e theksit tek perceptimi si burim ekzistence nga Berkeley dhe vënia e theksit te emocionet dhe perceptimet nga Hume, si bazament i njohjes, ishin argumentime se nuk ishte vetëm arsyeja burim i njohjes, por kishte edhe të tjera që duhej të merreshin parasysht, në mos më shumë, të paktën po aq sa edhe arsyeja.

### ***Rrëzimi i besimit në të vërtetën si tregues i përparimit të shkencës***

Filozofia kishte arritur, më në fund, përmes Imanuel Kantit të bashkonte dy drejtimit filozofike, atë të racionalizmit dhe të empirizmit, duke unifikuar të dyja qasjet. Nisur nga konstatimi se “arsyeja nuk mund të perceptojë, kurse shqisa nuk mund të mendojë”, Kanti pohon se “mendimet pa përmbajtje janë të zbrazëta, kurse perceptimet pa koncepte janë të verbëra”, prandaj alternativa është unifikimi i tyre: “Njohja, shprehet Kanti, zë fill vetëm kur këto dy aftësi [arsyeja dhe perceptimi] bashkohen.”<sup>26</sup> Më tej, është Auguste Comte ai që, duke e hjerrë metafizikën nga filozofia, e ngriti racionalitetin në stadin më të

---

<sup>25</sup> David Hume, *A Treatise of Human Nature* (1739-40), Book 2, Part 3, section 3, Oxford, at the Clarendon Press, 1896, f. 283.

<sup>26</sup> Imanuel Kant, *Kritika e mendjes së kulluar*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2002, f. 68.

lartë të zhvillimit intelektual: “arsyeja e çliruar” ka hyrë në “fazën përfundimtare të racionalitetit pozitiv”<sup>27</sup>.

Me këtë trashëgimi, dekadat e para të shekullit XX do të sjellin konstituimin e epistemologjisë si disiplinë më vete, gjë që do të bëhet nga pasuesit e pozitivizmit të Comtes, si dhe të Ernst Mach (1838-1916) dhe të Ludwig Wittgenstein (1889-1951), të mbledhur në Qarkun e Vjenës, të njohur si pozitivistët logjikë<sup>28</sup>. Duke kondensuar arritjet pozitive të shkencës dhe të filozofisë, pozitivistët logjikë do të konstituojnë qasje që njihet si verifikacionizëm, që “shpreh një pikëpamje teorike... thelbi i së cilës paraqet bindjen se qëllimi i kërkimit [shkencor] është verifikimi i teorive”<sup>29</sup>, respektivisht se vetëm pohimet të cilat mund të verifikohen empirikisht, domethënë përmes shqisave, janë kognitivisht kuptimplota dhe krijojnë mundësi për konstatimin e vërtetësisë së tyre. Me fjalë të tjera, teoritë shkencore verifikohen po qe se referenca e predikimeve të tyre konstatohet përmes vëzhgimit. Suksesi i shkencës matej me sasinë e pohimeve që verifikoheshin, domethënë me të vërtetat që zbuloheshin. Dukej se pikëpamja e pozitivistëve logjikë, kishte riafirmuar dhe ringritur në botëkuptim besimin e kamotshëm se mund të arrihej e vërteta, kësaj radhe përmes shkencave të ndryshme – dhe kjo ishte një tregues në dukje i qëndrueshëm, kur shkenca vazhdon edhe sot e kësaj dite të bëjë zbulime të mrekullueshme, të panjohura më parë.

Si për të zbehur ekzaltimin triumfues, mu në kohën kur ishte në lulëzim dhe shtrirje në gjerësi pikëpamja e pozitivistëve

---

<sup>27</sup> Auguste Comte, *Om positivismen*, Bokförlaget Korpen, MINAB, Surtre, Suedi, 1979, f. 14.

<sup>28</sup> Disa prej emrave më të eminentë janë Moritz Schlick (1882-1936), Otto Neurath (1882-1945), Hans Hahn (1879-1934), Rudolf Carnap (1891-1970), Alfred Ayer (1910-1989) etj.

<sup>29</sup> Hajdin Abazi, *Has Science Got Any Basic Principle? On the developments in the philosophy of science about the scientific progress*, Lambert Academic Publishing, Balti, 2017, f. 12.

logjikë, u shfaq një teori e kundër: falsifikacionizmi i Karl Popperit (1902-1994) i shprehur në *Logjikën e zbulimit shkencor*, më 1935. Popperi pohonte jo vetëm diçka në kundërshtim me teorinë verifikacioniste, por edhe krejt të pazakontë, sidomos kur kihet parasysh se shkencë ishte në marshim me arritjet e veta, se përparimi i shkencës bëhej përmes përgënjeshtimit të teorive shkencore që mbaheshin për të vërteta. Kjo ishte një përmbysje e besimit.

Popperi pohonte se një teori ishte shkencore vetëm po qe se ishte e testueshme dhe përmbante falsifikatorë potencialë e të tillë ishin pohimet bazike<sup>30</sup>; përkatësisht se secila teori shkencore përjashton disa evente, të cilat qëndronin si falsifikatorë potencialë<sup>31</sup>. Ndonjëra prej tyre do të mund të përgënjeshtrojnë teorinë. Teoritë shkencore nuk mund të verifikoheshin, por ato mund të falsifikoheshin. Kjo duhej të ishte kështu, pasi që, sikurse dëshmonte historia e shkencës, secila teori shkencore, që ndonjëherë me shekuj ishte besuar si e vërtetë, në fund ishte treguar e rreme; prandaj, intenca e Popperit ishte se sa më shpejt të arrihej përgënjeshtrimi i një teorie që duket e vërtetë, aq më shpejt përparonte shkencë. I tërë shndërrimi në shkencë përmes përgënjeshtimit, sipas Popperit, bëhej për t'iu përafuar të vërtetës, por pa e arritur atë ndonjëherë.

Ajo që nga pozitivistët logjikë konsiderohej si gabim ose si një punë jo e fytëshme kur një teori tregohet të ishte e rreme, Popperi e konsideronte atë si suksesin më të madh të mundshëm të shkencës<sup>32</sup>. Me guximin e pashoq intelektual Popperi e përmbysi bindjen mbisunduese se shkencë përparonte duke njohur të vërtetën dhe në vend të saj ai arriti të tregojë se sukcesi i vërtetë, I mirëfilltë dhe përparimi i njëmendtë bëhej pikërisht

---

<sup>30</sup> Karl Popper, *The Logic of Scientific Discovery*, Routledge Classics. London and New York, 2003, f. 19.

<sup>31</sup> Ibid., f. 66-67.

<sup>32</sup> Hajdin Abazi, *Has Science Got Any Basic Principle?* f. 17.

kur flakej një teori pasi ishte treguar me fakte se është e rreme dhe vendin e saj e zinte një teori tjetër, e cila u ka rezistuar sprovave për ta përgënjeshtuar, por që edhe kjo një ditë, pashmangshëm, do të pësonte të njëjtin fat, dhe sa më parë të ndodhte kjo, aq më shpejt do të përparonte shkencë - pikërisht për këtë veprimtaria e shkencëtarëve duhej të karakterizohej nga përpjekjet për të përgënjeshtuar secilën teori mbisunduese shkencore. Merita e madhe e Popperit qëndron se ai jo vetëm e legjitimoi përgënjeshtimin si të vlefshëm, por arriti të argumentojë me sukses se pikërisht për motive të tilla flakja e një teorie të vjetër dhe zëvendësimi i saj me një të re ishte mënyra e zhvillimit dhe përparimit të shkencës, e me këtë edhe e njohjes njerëzore.

Detyra e shkencave që nga fillimi ishin konsideruar si disiplina që kishin për mision të zbulonin të vërtetën dhe se veprimtaria e shkencëtarëve ishte e famshme pikërisht përmes zbulimeve të tyre me të cilat konstituoheshin njohuri të reja. Por Popperi ndryshoi kursin dhe hapi një perspektivë tjetër, ku arritja e së vërtetës ishte eliminuar dhe vendin e saj ia kishte zënë kërkimi shkencor me objektiv përgënjeshtimin e teorive shkencore që pretendonin të vërtetën - përmes të cilës shpjegohej mjaft mirë ndryshimi i shkencave të ndryshme përgjatë historisë. Shprehur në frymën e tematikës së shqyrtimit, këtu mund të thuhet se u zhvlerësua puna kërkimore e shkencëtarëve për të vërtetuar teoritë dhe u bë vlerë përpjekja e shkencëtarëve për të përgënjeshtuar ato. Qasja ishte përmbysur. Shndërrimet më të mëdha në shkencë bëheshin të lidhura me rezultatin e punës kërkimore për të përgënjeshtuar; nuk ishte verifikimi, po falsifikimi ai që qëndronte në themel të revolucionit shkencor, të kthesave vendimtare të përparimit.

Kështu, ishte Popperi ai i cili minoi autoritetin e së vërtetës në epistemologji dhe avokoi si kundër ekuivalencës përgënjeshtimin. Ajo çka është më interesantja te qasja e Popperit është se ai nuk e mohonte të vërtetën, përkundrazi, e

konsideronte atë disi në mënyrë kantine si “parim rregullues”, që në realitet ishte i paarritshëm ‘Eureka’ ishte zbulimi i kundërfakteve që e tregonin një teori shkencore të rreme.

### *Shkenca funksionon njëlloj edhe pa të vërtetën*

Përmbysja që kishte shkaktuar Karl Popperi me epistemologjinë e falsifikacionizmit ishte një përgjigje ndaj pyetjes së madhe, asaj se si bëheshin kthesat më të mëdha në zhvillimin e shkencës përgjatë historisë. Popperi kishte arritur të argumentonte se vendimtar për përparimin e shkencës ishte përgënjeshtrimi i një teorie dhe jo vërtetësia e saj. Nuk ishte mohuar ekzistenca e së vërtetës, por ajo ishte spostuar tutje si e paaftë për të qenë përcaktues për shndërrimet e mëdha shkencore – e këtillë mund të ishte e kundërta dhe kjo dukej si një përmbysje e asaj që dukej logjike, e drejtë, e duhur, dhe mund të jetë dukur si pikëpamja më destruktive në epistemologji, që shpriste atë që duhej të ishte epiqendra e zhvillimeve dhe e bënte atë një qasje që kërkimin shkencor e kthente përmbys. Duhet mbajtur parasysh se falsifikacionizmi nuk ishte nihilizëm, por ishte një qasje me kritere të caktuara saktë se si mund të arrihej deri te përgënjeshtrimi e që jo vetëm nuk ishte e lehtë aspak, por përkundrazi ishte tepër e vështirë e ndërmarre shumë komplekse sipas konceptit të Popperit. Falsifikacionizmi tregoi se nuk kishte një qasje të vetme në shkencë, se, në të vërtetë, kishte edhe mundësi të tjera qasjeje e shpjegimi, dhe e begatoi rezonimin epistemologjik mbi shkencën.

Sido që të jetë, duket se pa dashje Popperi kishte hapur “kutinë e Pandorës”. Epistemologë të tjerë do të postulojnë se shkenca mundet të funksionojë fare mirë edhe pa konceptin e së vërtetës. Të këtillë janë, fjala vjen, Thomas Kuhn dhe Paul Feyerabend, si dhe Hilary Putnam.

Shtytjen më të madhe, në këtë drejtim, pa fije dyshimi, e bëri Thomas Kuhn në kryeveprën e tij *Struktura e revolucioneve*



shkencore (1962). Kuhni pohonte, në kundërshtim me Popperin, se “na duhet të heqim dorë nga nocioni, i drejtpërdrejtë apo i nënkuptuar, se ndryshimet e paradigmes i ofrojnë shkencëtarët dhe ata që mësojnë prej tyre, gjithnjë e më pranë së vërtetës”<sup>33</sup>. Kjo domethënë se, sipas Kuhnit, shkenca nuk ka për synim t’i ofrohet ndonjë qëllimi të paracaktuar, përfshirë edhe të vërtetën. Kërkimin shkencor ai e konceptonte si përpjekje që natyrën, ose ndonjë pjesë të saj, ta fusin në kallëpet e paradigmes, ashtu që të harmonizohen faktet me teorinë. Kuhni e pohon edhe më qartë se shkencat mund të jenë zhvilluar “pa ndihmën e ndonjë pikësnyimi të vënë, për të arritur një të vërtetë shkencore të ngulitur një herë e mirë”<sup>34</sup>. Për Kuhnin “zhvillimi i shkencës, ngjashëm me evolucionin biologjik, është i njëdrejtimshëm dhe i pakthyesëm”<sup>35</sup> dhe në analogji me konceptin evolutiv, ai thekson se konflikti midis pjesëtarëve të komunitetit për të gjetur zgjidhje për problemet me të cilat ballafaqohet është rruga më e mirë në ushtrimin e shkencës, dhe kjo çon drejt të ardhmes së saj<sup>36</sup>. Është e qartë, ashtu sikurse e kam shprehur gjetiu, se Kuhni parashtron pikëpamjen e tij se shkenca nuk ka nevojë fare për nocionin e së vërtetës dhe se nuk është qëllimi i saj arritja e ndonjë të vërtete<sup>37</sup>.

Paul Feyerabendi e ka kritikuar Kuhnin se ky e ka zhveshur shkencën nga thelbi i saj, duke hequr qëllimin e së vërtetës<sup>38</sup>, si

---

<sup>33</sup>Thomas Kuhn, *Struktura e revolucioneve shkencore*, Dukagjini, Tiranë-Pejë, 1997, f. 234.

<sup>34</sup> Kuhn, *ibid.*, f. 237

<sup>35</sup> Kuhn në Lakatos & Musgrave, *Criticism and the Growth of Knowledge*, Proceedings of the International Colloquium in the Philosophy of Science, London, 1965, Cambridge University Press, London, 1970, f. 246.

<sup>36</sup> Kuhn, *Struktura e revolucioneve shkencore*, f. 235-236.

<sup>37</sup> Hajdin Abazi, *Shqyrtime të racionalizmit në epistemologji*, f. 196.

<sup>38</sup> Paul Feyerabend, “Consolations for the Specialist”, në Lakatos & Musgrave, *Criticism and the Growth of Knowledge*, Proceedings of the International Colloquium in the Philosophy of Science, London, 1965, Cambridge University Press, London, 1970, f. 201.

preokupim dhe objektiv i kërkimit shkencor. Por, në të njëjtën kohë, ai vet ofron një epistemologji anarkiste, sipas së cilës secila teori mund të mbahet nga secili grup shkencëtarësh dhe vetë fakti se një grup e përkrah dhe e beson, ajo është e drejtë dhe legjitime për ta, si dhe Feyerabend nuk ofron ndonjë mënyrë për të shquar vërtetësinë e teorive të ndryshme edhe kur ato mund të jenë nga e njëjta disiplinë dhe të jenë kontradiktore. Pohimi i Feyerabend se shkenca është rruga e njohjes së të vërtetës dhe realitetit<sup>39</sup>, mbetet një ornament, që nuk ka ndonjë peshë fare, përderisa jo vetëm teoritë e ndryshme dhe kontradiktore konsiderohen legjitime nëse një grup shkencëtarësh i mban ato, por, për më tepër edhe magjitë e ndryshme si wodo është e barasvlershme me shkencën. Po qe se shihet qartë, qëndrimi anarkist i Feyerabendit është minimi më i madh i së vërtetës, derisa nuk ka se si të shquhet e të njihet ajo, domethënë se secila mund të duket e vërtetë pa qenë fare e tillë

Duke qenë ndjekës i Popperit, Imre Lakatos nuk mund të avokonte të vërtetën, ndaj, në vend të saj, ai, zgjodhi rrugën e mesme, postuloi se përparimi i shkencës matet me zbulimin e fakteve të reja dhe teorive të reja<sup>40</sup>. Kjo tingëllon e ngjashme me atë që Kuhni e quan zgjidhje enigmash, që implikon kalibrimin e fakteve me teorinë dhe anasjelltas. Mirëpo, Hilary Putnam argumentoi bindshëm shembjen e dikotomisë fakt – vlerë<sup>41</sup>, duke treguar, në pajtim me Kuhn, Feyerabend dhe Lakatos, se në fakt ato janë të ndërthurrura dhe të pandara qartë ndërmjet tyre, me

---

<sup>39</sup> Feyerabend, *Mot Metodtvång* – Utkast till en anarkistisk vetenskapsteori. Arkiv modena klassiker, 2000, f. 8.

<sup>40</sup> Imre Lakatos, "Falsification and the Methodology of Research Scientific Programmes" në Lakatos & Musgrave (ed), *Criticism and Growth of Knowledge*, Proceedings of the International Colloquium in the Philosophy of Science, London, 1965, Cambridge University Press, London, 1970, f. 118, 155-157, 170, 175.

<sup>41</sup> Hilary Putnam, *The Collaps of the Fact/Value Dichotomy and other essays*, Harvard University Press, Cambridge, Massachusetts & London 2002, d. 1-8, 44, 137.

çka, faktikisht shembet, ajo që është njohur si objektivitet, pasi që nëse faktet nuk janë të pavarura nga vlerat (teoritë), atëherë ato nuk janë objektive. Kështu, në një farë mënyre, teorikisht minohet edhe referenca shtyllë e faktit si ekzistencë objektive dhe e pavarur.

### ***Zbehja e mbështetjes te autoriteti i së vërtetës***

Epistemologjia e shekullit të XX rezultoi në zbehjen e çdo mbështetjeje të asaj që njihet si objektive. Pozitivistët logjikë besonin se faktet ishin të dhëna, në kuptimin të kulluara, domethënë të pandikuara nga teoritë<sup>42</sup> dhe pikërisht për këtë ata besonin se faktet mund të ballafaqoheshin me referencën e teorive të ndryshme, si gur sprove për të gjykuar vërtetësinë ose jo të tyre. Dhe sikur të ishin faktet të kulluara, atëherë ato do të shërbenin si referenca vërtetësie.

Por Popperi, bashkëkohësi i pozitivistëve logjikë, argumentoi se përvoja është e ndikuar nga pikëpamjet teorike<sup>43</sup> dhe se faktet nuk janë pra të pastërta sikurse i pandehnin pozitivistët logjikë. Thomas Kuhn do të shkojë edhe më tej, kur thekson se konceptet tona (p.sh. paradigma, tradita, botëkuptimet, besimi metafizik etj.) janë ato që na tregojnë entitetet që i përmban gjithësia<sup>44</sup> që pastaj shkencëtarët kërkojnë të gjejnë ato. Në këtë frymë, Feyerabend tregoi se si teoritë e ngulitura ndikojnë në perceptimet edhe të shkencëtarëve, të cilat i pengojnë ata për t'i shquar faktet e reja dhe realitetet që ishin të ndryshme nga ato që i kultivonte tradita<sup>45</sup>. Me fjalë të tjera, Popper, Kuhn dhe

---

<sup>42</sup> Alfred Ayer, *Logical positivism*, The Free Press, New York, Cambridge University Press, 1959, f.18-19, 144.

<sup>43</sup> Popper, *Logic of Scientific Discovery*, f. 37.

<sup>44</sup> Kuhn, *Struktura e revolucioneve shkencore*, f. 24.

<sup>45</sup> Paul Feyerabend, *Mot Metodtvång*, f. 50. Ai shprehet se faktet "janë të përbëra nga ideologjitë e vjetra".

Feyerabend argumentuan se vëzhgimet tona, perceptimet e fakteve, janë të ndikuara, në mos të përcaktuara, nga teoritë.

Goditjen e fundit në këtë drejtim e dha Hilary Putnam. Putnam tregoi se nuk ekzistonte në të vërtetë ndarja e rreptë midis fakteve dhe vlerave (pikëpamjeve, besimeve, teorive), se ato ishin të ndërthurrura dhe të ndërvarura<sup>46</sup>. Se çka do të konsiderohet fakt, në të vërtetë, varet nga vlerat që i kanë pranuar dhe operuar me to shkencëtarët ose grupet e shkencëtarëve. Objektive, ose e vërtetë, mund të konsiderohet diçka vetëm po qe se vlerat ia japin një atribut të tillë, por në kundërshtim me këto vlera – faktet si dhe e vërteta nuk pranojnë si fakte dhe si e vërtetë.

Në një gjendje të këtillë kur epistemologjia ka shembur themelet e deritashme të besueshme, dhe përderisa nuk ka ndonjë teori tjetër që t'i ketë tejkaluar këto e të ketë ofruar ndonjë alternativë, nuk ka pse të duket absurde as fakti alternativ e as lajmet e rreme, si dhe 'të drejtat alternative'<sup>47</sup> etj. Këto, si dhe të tjera që mund të lulëzojnë, duket se janë fryte të vakuimit që ka ngel pas spostimit të së vërtetës dhe fakteve si ekzistenca objektive.

### *Shënime përmbyllëse*

Nga sa u tha deri këtu, pavarësisht se në vija të trasha dhe gjëra të njohura mirë, por të parashtruara në kontekstin e post-të-vërtetës, duket krejt e natyrshme shfaqja e qasjeve të reja. Zhvillimet e lartpërmendura në filozofi çuan në shembjen e autoritetit të së vërtetës. Filozofë dhe epistemologë të ndryshëm treguan se e vërteta, faktet e vëzhgimet njerëzore janë të

---

<sup>46</sup> Hilary Putnam, *The Collaps of the Fact/Value Dichotomy and ther essays*, pp. 1-8, 44, 137.

<sup>47</sup> alt-right (alternative rights) see <https://en.oxforddictionaries.com/word-of-the-year/word-of-the-year-2016>, parë më 3 dhjetor 2017.

mbarsura, në mos edhe të përcaktuara, nga pikëpamjet teorike. Faktet, që janë konsideruar si objektive, u tregua se janë të ndërthurrura me vlerat dhe se vetëm kur ato janë të përputhshme atëherë faktet bëhen fakte, ndryshe jo.

Epistemologjia tregoi se shkenca edhe pa u udhëhequr nga koncepti i së vërtetës, pa pasur për objektiv njohjen e së vërtetës mund të funksionojë njësoj, në kuptimin se shkencëtarët mund t'i bëjnë kërkimet e tyre. Kjo nuk duket aq e çuditshme, meqë është argumentuar se faktet janë jo vetëm të mbarsura nga teoria, por edhe se ndarja midis faktit dhe teorisë/vlerës nuk ekziston ashtu sikurse ishte besuar, se, në të vërtetë, ato janë të varura e të kushtëzuara njëra me tjetrën.

Krejt në fund, duke mbajtur parasysh se në këtë shtjellim nuk u është kushtuar vëmendje zhvillimeve të përgjithshme shoqërore dhe teknologjike që kanë ushtruar po ashtu ndikimin e vet të fuqishëm për shfaqjen e post-të-vërtetës, megjithatë mund të pohohet se nëse epistemologjia ka sjellë të dhëna nga historia se teoritë shkencore janë të rreme, se faktet nuk janë objektive dhe të pavarura ashtu sikundër besohej, se nuk janë të ndara faktet nga vlerat, se shkenca mundet të arrijë njohjen edhe pa u udhëhequr nga e vërteta, atëherë, dashje pa dashje, ajo ka krijuar konditat filozofike, domethënë frymën e klimën e nevojshme dhe i ka shtruar rrugën shfaqjes së konceptit post-e-vërteta. Ky sfond i filozofisë së shkencës dhe i ndikimit të saj duket se hedh dritë mbi shfaqjen e post-të vërtetës si qasje dhe pikëpamje si një frut i natyrshëm i zhvillimit intelektual. Këtu nuk shpjegohet nëse kjo qasje dhe kjo pikëpamje është e drejtë apo jo. Kjo do të përcaktohet nga zhvillimet intelektuale në të ardhmen, nëse ato do të sjellin ndonjë përgjigje që shkon më tej ose e tejkalon atë.

## **Bibliografia**

Abazi, Hajdin. *Shembja e Olimpfit. Rënia e zotave – ngrija e njerëzimit. Ese filozofike mbi çlirimin botëkuptimor*. Shtëpia botuese Olymp, Prishtinë, 2016.

Abazi, Hajdin. *Shqyrtime të racionalizmit në epistemologji*. Zef Serembe, Prishtinë, 2014.

Abazi, Hajdin. *Has Science Got Any Basic Principle? On the developments in the philosophy of science about the scientific progress*. Lambert Academic Publishing, Balti, 2017.

Hajdin Abazi “Transformimi përmbajtësor: *post-e vërteta* në mediat e sotme”, përfshirë në përmbledhjen e kumtesave të Konferencës së Dytë Ndërkombëtare për komunikimin dhe studimin e medieeve, titulluar “Historia e medieeve dhe transformimi i medieeve”, mbajtur më 23 shtator. Kolegji AAB. Prishtinë, 2017.

Ayer, Alfred. *Logical positivism*. The Free Press, New York, Cambridge University Press, 1959.

Berkeley, George. *Principle of Human Knowledge, Three Dialogues*. Oxford University Press, Oxford, 1999.

Comte, Auguste. *Om positivismen*. Bokförlaget Korpen. MINAB, Surtre, 1979.

Feyerabend, Paul. “Consolations for the Specialist”, në Lakatos & Musgrave, *Criticism and the Growth of Knowledge*.

Feyerabend, Paul. *Mot Metodtvång – Utkast till en anarkistisk vetenskapsteori*. Arkiv moderna klassiker, 2000.

Hume, David. *A Treatise of Human Nature (1739-40)*. Book 2, Part 3, section 3, Oxford, at the Clarendon Press, 1896.

Kant, Imanuel. *Kritika e mendjes së kulluar*. Libri Shkollor, Prishtinë, 2002.

*Mbi sfondin dhe ndikimin e mundshëm të epistemologjisë në shfaqjen e post  
të vërtetës*

Kuhn, Thomas. *The Structure of Scientific Revolutions*. Dukagjini. Tiranë-Pejë, 1997.

Kuhn, Thomas në Lakatos & Musgrave, *Criticism and the Growth of Knowledge*. Proceedings of the International Colloquium in the Philosophy of Science. London, 1965. Cambridge University Press. London, 1970.

Lakatos, Imre. "Falsification and the Methodology of Research Scientific Programmes" in Lakatos & Musgrave (ed), *Criticism and Growth of Knowledge*. Proceedings of the International Colloquium in the Philosophy of Science. London, 1965. Cambridge University Press. London, 1970.

Miller, David. *Popper - Vepra të zgjedhura*. Soros & Afërdita. Tiranë. Pa vit botimi.

Platon. *Kratylos*, Skrifter, Bok 2, Atlantis, Stockholm, 200.

Platon, *Staten*. Skrifter. Bok 3, Atlantis, Stockholm, 2013.

Platon. *Thaetetos*. Skrifter, Bok 2, Atlantis, Stockholm, 2001.

Popper, Karl. *The Logic of Scientific Discovery*. Routledge Classics. London and New York, 2003.

Popper, Karl. *Vepra të zgjedhura*. David Miller (ed). Soros & Afërdita. Tiranë. No year of publication.

Putnam, Hilary. *The Collaps of the Fact/Value Dichotomy and ther essays*. Harvard University Press. Cambridge, Massachusetts & London, 2002.

## ***Webliografia***

"Alt-right" në <https://en.oxforddictionaries.com/word-of-the-year/word-of-the-year-2016>

Higgins, Colin Francis, "Gorgias (483–375 B.C.E.)" në <http://www.iep.utm.edu/gorgias/>

Norman, Matthew. "Whoever wins the US presidential election, we've entered a post-truth world - there's no going back now", "Independent", 8 november 2016, në <http://www.independent.co.uk/voices/us-election-2016-donald-trump-hillary-clinton-who-wins-post-truth-world-no-going-back-a7404826.html>

Oxford Dictionaries: <https://en.oxforddictionaries.com/word-of-the-year/word-of-the-year-2016>)

Perkins, Dennis. "At the end of an ugly campaign, SNL's Trump and Clinton go on a feel-good rampage", 6 nëntor 2016, në <https://news.avclub.com/at-the-end-of-an-ugly-campaign-snl-s-trump-and-clinton-1798253954>